



02/Nr. 1149 /2020
Data: 11.02. 2020

PROCESVERBAL I KKSB-së

Nga mbledhja e parë - I- për vitin 2019 mbajtur me datë: 31.01.2020 me fillim pune në ora 14:00, prezent ishin: **Mallazum Qajani** (Nënkryetarë i Komunës), **Nuhi Dema** (përfaqësues nga stacioni policor), **Bedri Berisha** (përfaqësues i policisë kufitare –Vija e Gjelbërt), **Lorik Ramaj dhe Petrit Potera** (përfaqësues të FSK-së), **Menduh Vlashi** (përfaqësues i drejtorisë për arsim, kulturë, rini dhe sport), **Refet Kalisi** (përfaqësues i drejtorisë për shërbime publike dhe emergjencë), **Hyriete Isufi** (kryesuese e Komitetit për Komunitete), **Nusret Shiti** (përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame në Han të Elezit), **Amir Bushi** (përfaqësues nga zyra për barazi gjinore), **Isni Bushi** (përfaqësues i këshillit të prindërve), **Isa Shkreta** (përfaqësues i E.V.S.B), **Visar Hasallari** (përfaqësues i KVRL-së).

Takimin e kryesoi kryetari i komunës z. **Rufki Suma**.

RENDI I PUNËS

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
2. **Informatë mbi sigurinë në komunën e Hanit të Elezit.**
3. **Të ndryshme.**

Rufki Suma pasi përshëndeti të pranishmit lexoi rendin e punës dhe pasi që nga të pranishmit nuk pati vërejtje në rendin e punës, njëzëri u miratua rendi i punës.

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

Rufki Suma lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedhë në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar.

2. **Informatë mbi sigurinë në komunën e Hanit të Elezit.**

Rufki Suma lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nuhi Dema situata e sigurisë ishte e qetë gjatë këtij muaji.

Gjatë këtij muaji kemi pasur 4 (katër) raste dhe rasti më veçantë ishte punëtori që e humbi jetën në kompaninë “Sharrcem”.

Bedri Berisha gjatë këtij muaji kemi pasur një (1) rast.

Bashkëpunimi me palën Maqedone është duke vazhduar dhe kemi patrullime të përbashkëta. Siguria ishte e qetë rreth vijës kufitare.

Isni Bushi është mirë që te shitorja Besa me qëndruar një patroll e policisë për shkak se po vozisin me shpejtësi të madhe.

Qarkullojnë disa informata se disa të rinj janë zënë me mjete financiare fallc.

Nuhi Dema një rast ishte te “Shelli” të cilët kanë raportuar në polici dhe e kemi njoftuar njësinë adekuate prej Ferizajt.

Rasti i dytë ka qenë me një barnatore dhe personat janë zënë dhe janë në procedurë dhe me të merret regjioni.

Rufki Suma stacioni policorë e prezantojë raportin vjetorë të punës dhe ishte më me pakë raste.

Në rend të parë i përgëzojë qytetarët pastaj dhe policinë për një punë të përbashkët.

A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka si vlerësim i përgjithshëm është se gjendja e sigurisë në komunën e Hanit të Elezit është e mirë.

3. Të ndryshme.

Rufki Suma lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nusret Shiti afër banesës ku banojë unë, te hekrishtat e kanë një qenë dhe ka ankesa prej banorëve për shkak se bënë shumë zhurmë dhe është mirë që polica me ndërmarr diçka.

Nuhi Dema do të bisedojmë për këtë çështje.

Lorik Ramaj në mbledhjen e kaluar është ngritë çështja se tash është sezon e dimrit dhe ka mundësi që mund të bllokohen rrugët dhe si FSK kemi qenë të gatshëm për çdo intervenim.

Në dy shkolla të komunës së Hanit të Elezit është realizuar trajnimi për mjetet e pa shpërthyer.

Visar Hasallari kërkoj nga komuna që të ketë më shumë ligjërata në shkollën e mesme “Dardania” për dukuritë negative. Tash është stina e dimrit dhe po ka nxënës nga fshatrat të cilët po vonohen dhe është mirë që profesorët që 15 minutat e orës së parë mos me i shënuar .

Menduh Vlashi sa i përket fillimit të mësimit duhet të respektohen rregulli dhe nëse bien ndonjë borë e madhe e ndërpresim zhvillimin e mësimi.

Rufki Suma a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 15:00.

Procesmbajtësi

Avni Bushi


